



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 856 prot.

Tiranë, më 03/06 /2022

NJOFTIM PUBLIK PËR Z. ARBEN MEÇE

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi njofton z. Arben Meçe, në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa nr. 21, datë 01.02.2022, e Rrjetit të Organizatave R/E, Korçë, ku pretendohet diskriminim në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të “racës”, të pakicës kombëtare rome, nga ana e e Televizionit Vizion Plus dhe opinionistit Arben Meçe, në Emisionin “Spot LIGHT”, të moderuar nga z. Alban Dudushi, në Televizionin Vizion Plus, mbi Vendimin nr. 100, datë 23.05.2022, e KMD-së, ku është vendosur si më poshtë:

1. *“Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e z. Arben Meçe si pasojë e përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në Emisionin Spot LIGHT, të datës 21.01.2022, në televizionin Vizion Plus.*
2. *Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në formën e gjuhës së urrejtjes, të pakicës kombëtare rome, nga ana e Televizionit Vizion Plus, si pasojë e mosmbajtjes së një qëndrimi kritik ndaj gjuhës së urrejtjes së përdorur nga z. Arben Meçe në emisionin Spot LIGHT, për mosdistancimin në mënyrë publike nga përdorimi i saj, si dhe për përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome në titullin e emisionit Spot LIGHT, të publikuar në faqen www.youtube.com.*
3. *Referuar pikave 1 dhe 2 të këtij Vendimi, z. Arben Meçe dhe Televizioni Vizion Plus të shprehen me deklarata publike (verbale apo të shkruara) me anë të së cilave të kërkojnë falje ndaj pakicës kombëtare rome.*
4. *Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, Televizioni Vizion Plus të marrë masa të menjëherëshme për të ndryshuar titullin e emisionit Spot LIGHT, të datës 21.01.2022, si dhe eliminimin/mbulimin e frazës diskriminuese të përdorur nga z. Arben Meçe në përmbajtjen e këtij emisioni, të publikuar në faqen www.youtube.com, brenda 5 (pesë) diteve nga marrja dijani mbi këtë vendim, duke shmangur përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj pakicës kombëtare rome.*

5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, z. Arben Meçe dhe Televizioni Vizion Plus, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani."

Ky njoftim kryhet në kushtet kur, Komisioneri nuk disponon asnjë adresë të z. Arben Meçe, për të kryer korrespondencë zyrtare.

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhet Vendimi nr. 100, datë 23.05.2022, i KMD-së, drejtuar z. Arben Meçe, i kthyer mbrapsht nga shërbimi postar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

